Tetor 2024 | Nr. 42

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al

YouTube Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania

**NEGOCIATAT ME BE, ILD DISKUTIME MBI ASPEKTE TË PUNËS SË VET**



Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” | Sheshi “Nënë Tereza” | Godina nr. 13 | Tiranë, Shqipëri



## NEGOCIATAT ME BE, ILD DISKUTIME MBI ASPEKTE TË PUNËS SË VET

Njësia e Inspektorëve, ajo e Ndihmës inspektorëve dhe anëtarë të kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një takim konsultativ pune, ku u diskutua dokumenti "Pozicioni i përbashkët i Bashkimit Evropian", në kuadër të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë për grupkapitullin e parë themelor. Në pjesën e parë të takimit u diskutua mbi gjetjet e raportit për aspekte të veprimtarisë së In-





***Diskutimet u shtrinë në aspekte të proceseve të përditshme të punës, që nga administrimi i një ankese që mund të bëhet ndaj një gjyqtari a prokurori, e deri tek hetimi e procedimi disiplinor ndaj dhe u ndanë këndvështrime për përmirësimin e ritmit të punës, bazuar në kapacitetet ekzistuese.***

spektorit të Lartë të Drejtësisë dhe marrjen e masave të nevojshme në funksion të adresimit të gjetjeve. Diskutimet u shtrinë në aspekte të proceseve të përditshme të punës, që nga administrimi i një ankese që mund të bëhet ndaj një gjyqtari a prokurori, e deri tek hetimi e procedimi disiplinor ndaj dhe u ndanë këndvështrime për përmirësimin e ritmit të punës, bazuar në kapacitetet ekzistuese.







***Inspektorët dhe ndihmës inspektorët bënë krahasime me praktikën ekzistuese të punës me inspektimet tematike e institucionale, bazuar në metodologjinë e miratuar dhe mënyrat sesi mund të përdoren modelet e punës së propozuar nga ekspertët e CEPEJ.***

Në pjesën e dytë të aktivitetit, u paraqit manuali "Udhëzime dhe elemente metodologjie për kryerjen e inspektimit tematik në Shqipëri", hartuar nga ekspertët e CEPEJ në kuadër të bashkëpunimit me EU4Justice, për rritjen e eficencës së ILD-së.

Inspektorët dhe ndihmës inspektorët bënë krahasime me praktikën ekzistuese të punës me inspektimet tematike e institucionale, bazuar në metodologjinë e miratuar dhe mënyrat sesi mund të përdoren modelet e punës së propozuar nga ekspertët e CEPEJ.





***Në pjesën e dytë të aktivitetit, u paraqit manuali "Udhëzime dhe elemente metodologjie për kryerjen e inspektimit tematik në Shqipëri", hartuar nga ekspertët e CEPEJ në kuadër të bashkëpunimit me EU4Justice, për rritjen e eficencës së ILD-së.***



# KLP PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD PËR MASË DISIPLINORE NDAJ PROKURORIT A.B.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi pjesërisht kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor për magjistratin A.B., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për zvarritje të pajustifikuar në nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit për vendim penal të formës së prerë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer hetimin disiplinor me nismë të një ankuesi, që i është drejtuar ILD-së me ankesë ndaj magjistratit, për zvarritje mbi 3 vjeçare në nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal për ankuesin.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, rezultoi se magjistrati subjekt hetimi disiplinor, si prokurori me përgjegjësinë e zyrës së ekzekutimit të vendimeve penale, ka vonuar në mënyrë të pajustifikuar, për një kohë prej 3 vjet e 9 muaj, nxjerrjen e një akti procedural në shkelje të dispozitave ligjore neneve 462-466 të K. Pr. Penale dhe nenin 49/1 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar.

***Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, rezultoi se magjistrati subjekt hetimi disiplinor, si prokurori me përgjegjësinë e zyrës së ekzekutimit të vendimeve penale, ka vonuar në mënyrë të pajustifikuar, për një kohë prej 3 vjet e 9 muaj, nxjerrjen e një akti procedural në shkelje të dispozitave ligjore neneve 462-466 të K. Pr. Penale dhe nenin 49/1 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i ndryshuar.***

Nga hetimi disiplinor u konkludua, se veprimet/mosveprimet e magjistratit, përbëjnë shkelje disiplinore, që cënojnë figurën e magjistratit dhe besimin e publikut tek drejtësia.

Inspektori Lartë i Drejtësisë i propozoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që prokurorit A.B., t'i caktohet masa disiplinore "Ulja përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë deri në 1 vit", e parashikuar nga neni 108 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi pjesërisht kërkesën, duke caktuar si masë disiplinore ndaj prokurorit atë të "vërejtjes publike".

***Inspektori Lartë i Drejtësisë i propozoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që prokurorit A.B., t'i caktohet masa disiplinore "Ulja përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë deri në 1 vit", e parashikuar nga neni 108 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.***



# INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE NË SUEDI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë pune në Stokholm (Mbretëria e Suedisë). I shoqëruar nga ambasadorja e Shqipërisë në Suedi znj. Albana Dautllari, z. Metani dhe delegacioni i ILD-së, zhvilluan takime në Parlament, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Jashtme të Suedisë, në të cilat u prezantua funksioni dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe kontributi në forcimin e shtetit të së



**_Interesimi mbi ecurinë e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe punës së institicioneve për konsolidimin e demokracisë ishte në qendër të takimit që z. Metani zhvilloi në komisionin për çështje të BE në parlament me kryetarin e komisionit z. Erik Ottoson dhe më tej me dy deputetë shqiptare me origjinë nga Kosova, znj. Aida Birinxhiku dhe z. Arbër Gashi._**

drejtës, si një element kyç për procesin e negocimit të Shqipërisë për anëtarësim me Bashkimin Evropian.

Interesimi mbi ecurinë e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe punës së institicioneve për konsolidimin e demokracisë ishte në qendër të takimit që z. Metani zhvilloi në komisionin për çështje të BE në parlament me kryetarin e komisionit z. Erik Ottoson dhe më tej me dy deputetë shqiptare me origjinë nga Kosova, znj. Aida Birinxhiku dhe z. Arbër Gashi.

Z. Metani iu përgjigj interesit të bashkëbiseduesve edhe për cështje të pavarësisë së institucioneve dhe zhvillimeve demokratike në Shqipëri.

Në Ministrinë e Jashtme, në takimin me drejtuesen e departamentit për Evropën znj. Cecilia Ruhström-Ruin dhe drejtorin për Evropën Juglindore dhe zgjerimin e BE, z. Björn Linderfalk, u diskutua mbi ecurinë







e zbatimit të reformës në drejtësi në Shqipëri, me vëmendje rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistem.

Çështje të standardeve të punës së magjistratëve, besimit publik tek sistemi i drejtësisë dhe shkëmbimi i eksperiencave, u diskutuan në takimin që delegacioni pati në ministrinë e drejtësisë, me drejtoren e përgjithshme të marrëdhënieve me jashtë Dr. Anna-Carin Svensson.



***Çështje të standardeve të punës së magjistratëve, besimit publik tek sistemi i drejtësisë dhe shkëmbimi i eksperiencave, u diskutuan në takimin që delegacioni pati në ministrinë e drejtësisë, me drejtoren e përgjithshme të marrëdhënieve me jashtë Dr. Anna-Carin Svensson.***



## EKSPERIENCA SPANJOLLE PËR EFICENCËN E TRAJTIMIT TË ANKESAVE NË ILD

Një ekip i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i përbërë nga Njësia e Inspektorëve, e Ndihmës Inspektorëve, Drejtorisë së hartimit të akteve dhe shërbimeve juridike, të sektorit të Metodikës e standardeve, sektorit të Arkiv-protokollit, trajtimit të Ankesave dhe të sektorit të Teknologjisë së Informacionit, morën pjesë në një seri sesionesh pune, me një mision ekspertësh spanjollë, mbi vlerësimin e gjendjes dhe përparimin e bërë lidhur me ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë








(SMC), për të vijuar me një plan të transformimit digjital, në funksion të trajtimit të ankesave në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Eksperti i lartë z. Álvaro García vuri në dukje se aktiviteti është pjesë e mbështetjes së projektit EU4Justice për forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Misioni i ekspertëve spanjollë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë paraqiti eksperiencën e këtyre institucioneve, në funksion të rritjes së eficencës së ILD-së për trajtimin e ankesave, propozimin e zgjidhjeve dhe vlerësimin e protokolleve të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi cilësinë e menaxhimit të procesit të ankesave dhe një plan afatgjatë transformimi digjital.

Aktiviteti është vijim i eksperiencës së marrë në maj të këtij viti nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i Spanjës mbi situatën teknologjike të institucionit.

***Misioni i ekspertëve spanjollë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë paraqiti eksperiencën e këtyre institucioneve, në funksion të rritjes së eficencës së ILD-së për trajtimin e ankesave, propozimin e zgjidhjeve dhe vlerësimin e protokolleve të punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi cilësinë e menaxhimit të procesit të ankesave dhe një plan afatgjatë transformimi digjital.***






## EKIPI I ILD-SË PËRFUNDON FAZËN E DYTË TË TRAJNIMIT MBI INSPEKTIMET

Njësia e Inspektorëve dhe ajo e ndihmës inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim 3 ditor në Tiranë, mbi rritjen e efikasitetit të ILD-së në drejtim të inspektimeve tematike dhe institucionale, mbështetur nga projekti EU4Justice.

Trajnimi kishte në fokus përgatitjen, kryerjen dhe analizimin e inspektimit institucional pranë gjykatave dhe prokurorive dhe u zhvillua si ndërthurje e kuptimit teorik me zhvillimin e aftësive në praktikë, për të krijuar një mjedis të favorshëm dhe bashkëpunues në konceptimin dhe kryerjen e inspektimit institucional, nga eksperti magjistrat francez, z.Vincent Delbos dhe











ekspertja magjistrate rumune znj.Nicoleta Rhfir. Pjesë e këtij trajnimi ishin edhe çështjet etike për inspektimet institucionale e më tej, hetimet disiplinore.

Aktiviteti është faza e dytë e trajnimit të zhvilluar në qershor të këtij viti me të njëjtin fokus, si pjesë e projektit për forcimin e kapaciteteve të inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve të ILD-së në përmbushjen e funksioneve, në përputhje me nenin 194 të Ligjit Nr. 115/2016 për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, bazuar mbi praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Forcimi i kapaciteteve të njësive të inspektimit përmes trajnimit të vazhdueshëm me standardet dhe praktikat më të mira të punës, europiane e ndërkombëtare është prioritet sistematik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.





# TETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Tetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **84 ankesa** nga qytetarë dhe institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Tetor 2024.** Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

| ARKIVIME | VERIFIKIME | PROCESI DISIPLINOR |
|---|---|---|
| **73 praktika të trajtuara** nga të cilat:<br>• **41 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar** (6 praktika të bashkuara)<br>• **17 vendime arkivimi pas verifikimit** (9 ankesa të bashkuara) | **5 vendime verifikimi (5 ankesa të trajtuara)** | • **4 vendime për fillim hetimi disiplinor (2 gjyqtarë, 2 prokurorë**) |

# ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD **www.ild.al**, në seksionin "**Si pranohen ankesat**".

# SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Tetor 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuara prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.










Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.





**Gjatë muajit Tetor 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:**

⇒ **ka pritur 27 ankues,**

**të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe**

⇒ **ka realizuar 17 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.**




## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Tetor 2024**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **10 kërkesa për informacion,** të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

# ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...**
@ILD_Albania

Kënaqësi profesionale e personale komunikimi institucional në Suedi 🇸🇪 mbi rolin e ILD-së në sistemin e drejtësisë në Shqipëri 🇦🇱 dhe parime të shtetit të së drejtës, pavarësisë e forcimit të demokracisë. 👇
@AlEmbassySweden @ADautllari

Translate post




From ild.al

1:14 PM · 4.10.24 From Earth · **326** Views

---

**Post**

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...**
@ILD_Albania

Great discussions on the role of HIJ in the justice system in 🇦🇱 and the principles of the rule of law⚖️, independence and strengthening of democracy during my working visit in🇸🇪 institutions. 👇
@AlEmbassySweden @ADautllari
ild.al/en/2024/10/04/...

1:40 PM · 4.10.24 From Earth · **252** Views

---

**Post**

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...**
@ILD_Albania

Forcimi i kapaciteteve të njësive të inspektimit përmes trajnimit të vazhdueshëm me standardet dhe praktikat më të mira të punës, europiane e ndërkombëtare është prioritet sistematik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. #ILD🇦🇱 #EU4Justice🇪🇺 👇
ild.al/sq/2024/10/04/...

Translate post

9:03 AM · 5.10.24 From Earth · **39** Views

---

Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani reposted

**Mimoza Koçiu**
@MimozaKociu

Edhe këtë vit, çunat e #ILD⚖️, pjesë e Maratonës së Tiranës🏃, 🏃, #tiranamarathon #run #IlD⚖️#Tirana ❤️

Translate post




12:08 PM · 20.10.24 From Earth · **563** Views

---

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...**
@ILD_Albania

Reflektuam mbi standardet tona të punës me përgjegjshmëri, paanësi e dinjitet profesional! #ILD⚖️ 👇

Translate post




From ild.al

1:33 PM · 24.10.24 From Earth · **47** Views

---

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur M...**
@ILD_Albania

📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD⚖️
✅6572 të konfirmuara
✅5581 të trajtuara
✅991 në proces trajtimi
✅209 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
✅124 magjistratë të hetuar
✅41 kërkesa për procedim disiplinor
❓ Si mund të ankohem në ILD? 👇
ild.al/sq/pyetje-te-s...

Translate post




8:30 AM · 28.10.24 From Earth · **11** Views

## TETOR 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

## KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri







*Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD*